



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PARANDALIMIT TË
PASTRIMIT TË PARAVE

RAPORTI VJETOR 2021



RAPORTI VJETOR 2021



Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë Bulevardi
"Dëshmorët e Kombit", nr. 3 Tiranë.
Tel: +355 42 24 4 602
www.fiu.gov.al

PËRMBAJTJA

SHKURTIMET	4
MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	5
MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDHRA E BLOKIMIT TË PËRKOSSHËM	6
Analizimi dhe dërgimi i informacionit në organet e zbatimit të ligjit	8
Urdhrat e bllokimit të përkohshëm	11
TIPOLOGJI TË RASTEVE TË DËRGUARA NË ORGANET LIGJZBATUESE	12
Tipologji 1: Transaksione nga persona të përfshirë në grup kriminal	12
Tipologji 2: Përfshirja e personave me precedentë penalë në shoqëri ndërtimi	14
Tipologji 3: Hua dhe sponsorizime të dyshimta nga një PEP	16
Tipologji 4: Blerje pasurish të paluajtshme nën vlerë dhe rivlerësim brenda një kohe të shkurtër	17
Tipologji 5: Rast mashtrimi financiar kryer nga një subjekt juridik	18
Tipologji 6: Përdorimi i personave të tretë për investime në fushën e ndërtimit	20
Tipologji 7: Këmbimi i pasurive dhe përdorimi i dyshimtë i kredive	22
Tipologji 8: Investim në vlerë të lartë në pasuri të paluajtshme në mënyrë jo të drejtpërdrejt	24
Tipologji 9: Transaksione të dyshimta nga subjekte juridike në fushën e mjekësisë	25
Tipologji 10: Investime në pasuri nga PEP me vlerë të deklaruar nën çmim tregu	27
NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE DHE ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË	29
Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese	29
Analizimi i përputhshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë:	31
MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESET GJYQËSORE	33
Masat administrative	33
Ekzekutimi i masave administrative dhe proceset gjyqësore	36
BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR	37
Bashkëpunimi kombëtar ndër-institucional	37
Shkëmbimi i informacioneve me NjIF	40
Procesi i vlerësimit nga Moneyval dhe FATF	41
Ndryshime ligjore	43
BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TI	44
Buxheti dhe menaxhimi i tij	44
Menaxhimi i burimeve njerëzore	46
Teknologjia e informacionit	48
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2022	49

SHKURTIMET

AMF	– Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
ASHK	– Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BE	– Bashkimi Evropian
BSH	– Banka e Shqipërisë
BMP	– Bordi i Mbikëqyrjes Publike
DPD	– Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPPP	– Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
DPPSH	– Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPT	– Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DSIK	– Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
Egmont	– Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë
FATF	– Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar
KiE	– Këshilli i Evropës
IFJB	– Institucion Financiar Jo-Bankë
Moneyval	– Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
NjIF	– Njësi e Inteligjencës Financiare
PP/FT	– Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit
PP	– Prokuroria e Përgjithshme
OJF	– Organizatë Jo-Fitimprurëse
QKB	– Qendra Kombëtare e Biznesit
RAD	– Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë
SHKK	– Shoqëri Kursim Krediti
SHISH	– Shërbimi Informativ i Shtetit
SPAK	– Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
ZKV	– Zyrë Këmbimi Valutor
TI	– Teknologjia e Informacionit

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Të nderuar,

Është kënaqësi e veçantë të prezantoj përpara Jush raportin e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për vitin 2021. Publikimi i këtij raporti është momenti kryesor ku institucioni që drejtoj i prezanton jo vetëm institucioneve Shqiptare por në mënyrë të veçantë publikut të gjerë veprimtarinë e tij, arritjet dhe rezultatet konkrete në këtë rrugëtim 1 vjeçar.

Ky publikim edhe si detyrim ligjor për informimin publik, mbart brenda ndjenjën më të lartë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies ndaj çdo qytetari, duke bërë të mundur njohjen nga afër me aktivitetin dhe performancën e DPPPP në kuadër të forcimit të sistemit parandalues në vend, mbrojtjes së sistemit financiar, rritjes së sigurisë dhe luftës pa kompromis ndaj fenomeneve dhe aktiviteteve kriminale që gjenerojnë të ardhura të jashtëligjshme.

Veprimtaria e DPPPP gjatë këtij viti, përveç përmbushjes së funksionit parësor të institucionit si Njësi e Inteligjencës Financiare në Shqipëri, ka përfshirë edhe realizimin sa më efektiv të rolit mbikëqyrës të subjekteve të ligjit, mbështetjen e vazhdueshme të subjekteve nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit në funksion të zbatimit të legjislacionit PPP/FT, në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit Shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të BE-së, koordinimin e punës me institucionet Shqiptare dhe raportimin periodik në Komitetin MONEYVAL të KiE dhe ICRG/FATF, në kuadër të procesit të vlerësimit të vendit.

Një nga treguesit që presim të sjellë rezultate të mëtejshme në forcimin e sistemit parandalues në vend duke kontribuar në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të fushës, është hyrja në fuqi e ndryshimeve të fundit në ligjin

nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar), në Dhjetor 2021, ndryshime që përafrojnë tashmë plotësisht kuadrin ligjor Shqiptar me aquis të BE, Direktivën 4 dhe 5 (2015/849 ndryshuar me 2018/843 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”) ndryshime ligjore të cilat besojmë se do të sigurojnë mbrojtjen dhe parandalimin e sistemit financiar dhe të ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

DPPPP në cilësinë e institucionit koordinues, ka siguruar me sukses mbarëvajtjen e raportimeve në Komitetin Moneyval të KiE dhe ICRG/FATF duke siguruar një rritje të vlerësimit nga këto organizma ndërkombëtare në lidhje me adresimin e shumicës së pikave të Planit të Veprimit të hartuar me qëllim adresimin e rekomandimeve të FATF.

Kjo veprimtaria do të intensifikohet më tej edhe gjatë vitit 2022, duke synuar finalizimin e procesit të vlerësimit nga ICRG/FATF, koordinimin me institucionet e tjera për marrjen e masave të mëtejshme për adresimin plotësisht të rekomandimeve të FATF, konsolidimin e procesit të përputhshmërisë mbi bazat e faktorëve të riskut dhe rritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me autoritetet mbikëqyrëse dhe organet ligj zbatuese.

Në përfundim, dua të falënderoj dhe vlerësoj maksimalisht përpjekjet, përkushtimin dhe punën e të gjithë kolegëve të DPPPP, të cilët në sajë të angazhimit të tyre të palodhur, pavarësisht vështirësive dhe kufizimeve të zgjatura në kohë nga pandemia Covid-19, kanë bërë të mundur arritjen e rezultateve të prezantuara në këtë raport dhe të realizojnë punët në lartësinë e kërkesave të duhura profesionale.

MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDHURAT E BLOKIMIT TË PËRKOHSHËM

Për Njësitë e Inteligjencës Financiare, siç është DPPPP, RAD e raportuara nga subjektet e ligjit kanë rëndësi thelbësore, pasi mbi bazën e tyre vijohet me analizat, dërgimet e informacionit në agjencitë e zbatimit të ligjit, identifikimin e tipologjive PP/FT dhe kategorizimin e transaksioneve të përfshira.

Gjatë vitit 2021, në DPPPP janë dërguar 1,581 RAD nga subjektet raportues, të cilat paraqiten të kategorizuara në tabelën 1, të krahasuara me periudhat pararendëse.


Tabela 1: RAD të raportuara, sipas kategorisë së subjekteve për periudhën 2017-2021.

Subjekti raportues	2017	2018	2019	2020	2021
Banka	686	563	651	703	725
Shoqëri transfertash	165	247	319	315	290
DPD	46	49	43	44	33
DPT	5	10	12	10	6
ASHK	83	164	33	0	16
Noter	254	469	335	321	482
ZKV	20	7	6	4	4
Insti. financiare të mikro-kredisë	10	2	0	9	17
Shoqëri të qiradhënies financiare	5	2	0	0	1
Shoqëri ndërtimi	5	0	5	2	2
Shoqëri tregtimi mjeteve motorike	101	6	10	0	0
Shoqëri pagesash elektronike	2	6	0	0	3
Tjetër	2	0	10	1	2
Total	1,384	1,525	1,424	1,409	1,581

Bazuar në të dhënat e tabelës rezultojnë se vazhdojnë të mbizotërojnë raportimet e sistemit bankar, të cilat për vitin 2021 përbëjnë 46% të numrit total të RAD, e ndjekur nga raportimet nga subjektet noter me 30 % dhe institucionet financiare për transferimin e parasë me 18%.

Këtë vit kemi rritje me 50% të RAD të dërguara nga subjektet noter dhe një rritje e lehtë nga subjektet banka, ndërsa tek subjektet e tjera vihet re e njëjta tendencë. Gjatë vitit 2021 noterët kanë qenë një nga kategoritë kryesore në fokus për trajnim nga DPPP.

Grafiku 1: Ecuria e raportimeve të RAD për periudhën 2017-2021



Nga RAD e dërguara përgjithësisht vazhdojnë të mbizotërojnë tipologjitë që lidhen me:

- Blerje të pasurive të paluajtshme apo të luajtshme me burim të panjohur të fondeve;
- Transferta të dyshimta apo me anomali të dukshme;
- Veprime nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale të mëparshme;
- Huamarrje/sponsorizime/dhurime për/nga të tretë, që në dukje janë fiktive;
- Depozitime me para në dorë me burim të pajustificuar të ardhurash;
- Transaksione të pa mbështetura me dokumentacion, apo të dhëna të tjera të besueshme mes personash juridik;
- Veprime/transaksione/investime të dyshimta nga PEP apo persona të lidhur me ta.

Analizimi dhe dërgimi i informacionit në organet e zbatimit të ligjit



Analiza e informacionit është një proces kompleks i mbështetur në një sërë elementësh si të indikatorëve të detektuar, analizë të informacionit të rezultuar dhe siguruar, kryqëzim të dhënash, për të zbuluar raste të dyshimta në funksion të parandalimit të PP/FT, me qëllim dërgimin për investigim në agjencitë e zbatimit të ligjit, organet e inteligjencës apo NJIF partnere, veprimtari kjo që synon funksionimin e një sistemi efektiv parandalues. Baza e të dhënave e përditësuar në vazhdimësi, aksesit në informacion si dhe shembujt më të mirë nga

praktikat ndërkombëtare ndihmojnë këtë proces të evoluojë duke iu përshtatur vazhdimisht dinamikës së realitetit.

Një nga funksionet më të rëndësishme të DPPPP, është mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e informacioneve për rastet e dyshimta tek organet e zbatimit të ligjit konkretisht me Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, DPPSH.

Tabela 2: Rastet e dërguara në organet ligj zbatuese për periudhën 2017 – 2021.

Viti	2017	2018	2019	2020	2021
Prokurori	131	33	25	41	50
Polici	270	343	241	227	208
Total	401	376	266	268	258

Ndër rastet e dërguara në Prokurori, mbizotërojnë ato të dërguara në Prokurorinë e Posaçme të cilat përbëjnë 58% totalit, e më tej në Prokurorinë e Tiranës rreth 30 % dhe për pjesën tjetër vërehet një shpërndarje e rasteve në Prokuroritë e rretheve Durrës, Lezhë, Sarandë, Fier, Berat, Gjirokastrë.

Vlen të përmendet se pesha më e madhe të rasteve të dërguara nga DPPPP i janë adresuar DPPSH, si organi ligj zbatues kryesor në vend dhe i specializuar për kryerjen e veprimeve hetimore.

Krahas dërgimit të rasteve në Prokurori dhe Polici gjatë vitit 2021 ka patur edhe 24 raste të dërguara në DPT të konkluduara me dyshime për evazion fiskal/fshehje të ardhurash apo shkelje të tjera të legjislacionit tatimor.

Në këtë kontekst gjatë vitit 2021, DPPPP ka dërguar 60 informacione në SHISH në lidhje me çështjet të dyshuara për aktivitet kriminal objekt i përbashkët interesi mes dy institucioneve.

Përveç dërgimit të rasteve të reja, me rëndësi mbeten edhe informacionet vijuese apo të dhënat e reja të lidhura me çështje të dërguara më herët, të cilat konfirmojnë dhe thellojnë dyshimet e konstatuara për këto raste.

Tabela 3: Informacionet e dërguara në DPPSH 2020-2021 dhe ecuria e tyre.

Viti	2020	2021
Rastet në DPPSH nga DPPP	227	208
Referime nga DPPSH me indicie nga DPPP	110	72

Ndër rastet e dërguara nga DPPP për 2021, 72 prej tyre kanë shërbyer si indicie për referimet e bëra nga DPPSH për nenin 287 të Kodit Penal.

Për sa i përket indicies nga kanë filluar rastet e dërguara në agjencitë ligj zbatuese, rezulton se burim kryesor i tyre mbeten RAD nga subjektet e ligjit, të cilat kanë shërbyer si pikë nisje për rreth 96 % të referimeve.

Tabela 4: Indiciet për rastet e dërguara gjatë vitit 2021 në DPPSH dhe Prokurori.

Indiciet	RAD	Analiza sektoriale	NjIF Partnere	Njoftime/Burime të hapura	Total
Raste të dërguara në Prokurori	47	2	1	0	50
Raste të dërguara në Polici	200	2	3	3	208
Total	247	4	4	3	258

Fakti që dominojnë bindshëm rastet e dërguara me indicie nga RAD, është tregues i drejtpërdrejtë i efektivitetit të sistemit parandalues.

DPPP i kushton rëndësi edhe identifikimit të mënyrës së veprimit dhe metodave të ndjekura për kryerjen e pastrimit të produkteve të veprës penale apo financimit të terrorizmit, dhe konkretisht gjatë vitit janë vërejtur kryesisht këto tregues të aktivitetit të dyshimtë:

- Investime të larta në pasuri të paluajtshme me burim të panjohur fondesh;
- Transferta të dyshimta (në mbërritje apo në dalje edhe në tentativë) me përfshirje të subjekteve/shtetasve të huaj dhe të pajustificuara me dokumentacion mbështetës;
- Sponsorizime/ dhurime/ dhënie huaje nga/ për të tretë pa u konstatuar lidhje të dukshme që justifikojnë transaksionet mes palëve;
- Transaksione të pazakonta krahasimisht me profilin financiar të personit/subjektit;

- Investime në mallra luksi nga persona të cilat nuk justifikojnë burimin e fondeve apo persona me precedentë penalë;
- Mashtrime të formave të ndryshme;
- Transaksione financiare të kryera nga persona me precedentë të mëparshëm penalë apo persona të lidhur me ata me precedentë;
- Transferta të dyshimta me vende të konsideruara me risk;
- Ndërmjetësime të dyshimta në transaksione nga profesionistë të lirë për përfitime të dyshuara pjesërisht si të paligjshme,
- Transferta të mëdha vlerash (brenda dhe jashtë vendit) midis personave juridik të pa mbështetura me dokumentacion;
- Veprime/transaksione/investime të dyshimta nga PEP apo persona të lidhur me ta.

Gjatë analizës së informacionit i është kushtuar vëmendje edhe identifikimit të burimit të fondeve, pasurisë, veprimtarisë së paligjshme, si dhe lidhjeve të mundshme kriminale të personave dhe subjekteve.

Tabela 5: Të dhëna për klasifikimin e veprës së origjinës për periudhën 2017 – 2021.

Veprat e origjinës	2017	2018	2019	2020	2021
Krime në fushën e narkotikëve	43	31	28	35	39
Trafikim i qenieve njerëzore / shfrytëzim prostitucioni	2	2	5	4	3
Veprime/investime nga grupe kriminale	5	3	4	2	11
Veprime nga persona të dyshuar si të përfshirë në terrorizëm apo FT	5	2	4	6	3
Mashtrime (financiar, kompjuterike)	15	13	18	13	21
Falsifikim	5	2	4	2	3
Shpërdorim detyre / Korrupsion / Dyshim për ushtrimi të ndikimit të paligjshëm	13	5	10	12	21
Mos deklarim shumave dhe sendeve me vlere në kufi	1	1	3	4	0
Vjedhje, grabitje, kanosje	7	6	5	5	1
Trafikim i mjeteve motorike/ shmangie detyrime doganore/kontrabandë	0	0	3	3	0
Dyshime për evazion fiskal/(fshehje të ardhurash)	16	5	14	9	4
Precedentë të mëparshëm kriminalë	17	19	17	11	7
Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	-	-	-	4	0
Nuk dihet	272	287	151	158	145
Total	401	376	266	268	258

Tabela e mësipërme paraqet rastet e dërguar në organet ligj zbatuese Prokurori dhe DPPSH, për të cilat është arritur të identifikohet vepra e origjinës. Edhe për vitin 2021 numrin më të lartë të veprimtarive kriminale, për të cilat është bërë i mundur identifikimi i lidhjes me veprën e origjinës e zënë krimet në fushën narkotike, e më tej nga mashtrimi, shpërdorim detyre / korrupsion / dyshim për ushtrimi të ndikimit të paligjshëm, veprime / investime nga grupe kriminale, etj.

Në linjë me vitet e mëparshme, mbizotërojnë rastet për të cilat vepra penale e origjinës nuk ka qenë e mundur të përcaktohet. Për këto raste analiza financiare ka konkluduar se:

- Veprimet financiare kanë patur anomali të dukshme;
- Fondet e përdorura nuk kanë patur burime të ligjshme;

- Qëllimi ekonomiko-ligjor ka qenë bindshëm i dyshimtë;
- Kanë pasur ngjashmëri të theksuara me tipologjitë e njohura ndërkombëtare,

raste të cilat dërgohen për ndjekje të mëtejshme duke u bazuar në parimin “ndiq paranë” që është një nga më themelorët në punën e NJIF.

Duke marrë në konsideratë se eksponentët e krimit, për të cilët disponohen të dhëna për veprimtari kriminale, apo personat për të cilët nga burime të ndryshme rezultojnë të dhëna për shpërdorim detyre/korrupsion, tanimë janë të familjarizuar për rreziqet ligjore që mund të kenë në rast kryerje transaksionesh në emër të tyre apo familjarëve, ka pritshmëri që një pjesë e rasteve për të cilat nuk rezulton vepër kriminale e lidhur në fazën e trajtimit të rasteve nga DPPPP, të jenë pikërisht të lidhura me dy grupimet e sipërcituara.

Urdhrat e bllokimit të përkohshëm

Në rastet kur DPPPP ka arsye të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete për PP/FT, në funksion të parandalimit të tjetërsimit të produkteve financiare kriminale, urdhëron bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit

financiar, për një periudhë jo më shumë se 72 orë dhe informon Prokurorinë për, tanimë prej vitesh, informohet njëkohësisht dhe DPPSH, në funksion të realizimit të veprimeve procedurale.

Gjatë vitit 2021, janë nxjerrë në total 3 urdhra bllokimi të përkohshëm për llogari bankare, në një vlerë totale prej rreth 250,240 EUR, të cilat janë sekuestruar me vendim të Prokurorisë apo Gjykatës në masën 80%.

Tabela 6: Urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimet (në EUR) për periudhën 2017 – 2021.

Viti	Nr. i urdhrave të bllokimit nga DPPPP	Shuma totale e bllokuar (EUR)	Shuma totale e sekuestruar (EUR)	Raporti sekuestrime/bllokime
2017	52	11,263,587	9,096,233	81%
2018	24	5,428,270	4,536,595	84%
2019	16	9,699,690	7,841,091 ¹	81%
2020	7	1,172,291	1,172,886	100%
2021	3	250,240	200,000	80%

Krahas urdhrave të bllokimit, gjatë vitit 2021 DPPPP ka përdorur me shumë sukses edhe mekanizmin e monitorimit të llogarive bankare. Sipas dispozitave ligjore në fuqi, DPPPP urdhëron, kur ka arsye të

bazuara për PP/FT, monitorimin, gjatë një periudhe të caktuar të veprimeve bankare që janë duke u kryer përmes një ose më shumë llogarish të përcaktuara.



¹ Duke konsideruar dhe 940.000 EUR pasuri të paluajshme të sekuestruara në bazë të informacionit të dërguar nga DPPPP, vlera totale është 8.7 milion EUR

TIPOLOGJI TË RASTEVE TË DËRGUARA NË ORGANET LIGJZBATUESE

Në kuadër të paraqitjes së këtyre tipologjive, parashtrijmë se emrat e përdorur janë fiktivë dhe nuk lidhen me emra personash apo subjektësh konkret.

Tipologji 1: Transaksione nga persona të përfshirë në grup kriminal

Shtetasi A shtetas shqiptar, është kthyer në Shqipëri pas një qëndrimi të gjatë në një shtet të Amerikës së Jugut, për të cilin kishte të dhëna se ishte i përfshirë në trafikim të lëndëve narkotike.

Ky shtetas regjistroi në Shqipëri, shoqërinë tregtare 'DEF' me fushë veprimtarie 'import - eksport të mallrave të ndryshëm' duke deklaruar se mallrat do të importoheshin nga vendi ku kishte qëndruar prej shumë vitesh.

Për zhvillimin e kësaj veprimtarie tregtare shtetasi A mori hua shumë prej 300,000 EUR nga shtetasi B, për të cilin u zbuluan gjetje negative për përfshirje në veprën penale të mashtrimit.

Nga verifikimet e kryera shtetasi A kishte lidhur disa kontrata për investime në pasuri të paluajtshme dhe një marrëveshje ndërmjetësimi me shtetasen X, për shitjet e pasurive të paluajtshme të kësaj të fundit, ku shtetasi A do të përfitonte në shumë të konsiderueshme fondesh, nga roli i tij si ndërmjetës.

Në lidhje me shtetasen X rezultoi të jetë bashkëshortja e shtetasit të quajtur Y, ku për këtë të fundit disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari kriminale.

Nga analiza e veprimtarisë së shtetase X u konstatuan disa anomali si vijon:


- Shtetasja X kishte përfituar nëpërmjet dhurimit një pasuri e paluajtshme në vlerë të lartë tregu, në pronësi të disa shtetasve, familjarë midis tyre. Prona ndodhej në një njësi administrative, administratorja e së cilës ishte shtetasja C, e cila lëshoi vërtetimin përkatës për të mundësuar tjetërsimin e pronës. Nga të dhënat e gjeneruara nga burimet e hapura, shtetasja C rezultoi lidhje e afërt familjare me shtetasin Y (bashkëshorti i shtetases X).

- Shtetasja X rezulton se ka kryer disa transaksione të njëpasnjëshme të shit-blerjes së pasurive të paluajtshme, kundrejt palëve për të cilët ka dyshime për përfshirje në veprimtari kriminale;

Bazuar në dyshimet:

- Regjistrimi i një aktiviteti tregtar nga persona të përfshirë në trafikim të lëndëve narkotike dhe dyshimet lidhur me aktivitetin real të tyre;
- Përfshirja në transaksione të shit-blerjes, dhurimit të pasurive të paluajtshme në vlera të larta të shtetasve të dyshuar për përfshirje në veprimtari kriminale;
- Roli i shtetasit A të dyshuar, si ndërmjetës në transaksionin e shitblerjes së pasurisë;

rasti është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.



Tipologji 2: Përfshirja e personave me precedentë penalë në shoqëri ndërtimi

Shtetasja A, në vitin 2016 ka regjistruar një shoqëri ndërtimi 'Beta' shpk si ortakë e vetme. Kjo shoqëri në vitin 2019 ka fituar lejen për ndërtimin e një kompleksi në një zonë bregdetare në vendin tonë.

Nga verifikime e kryera rezultoi se shtetasja A, është motra e shtetasit B i cili është akuzuar për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

Nga analiza e aktivitetit të shoqërisë u konstatua se gjatë tre viteve kjo shoqëri kishte deklaruar fitime minimale ose humbje financiare pranë organeve tatimore.

Për realizimin e ndërtimeve shoqëria 'Beta' shpk fillimisht lidhi një marrëveshje financimi me shoqërinë 'Alpha' në vlerën 2.000.000 EUR. Bazuar në kontratën e financimit u transferuan nga shoqëria 'Alpha' tek shoqëria 'Beta' shpk, 20% e vlerës (pra 400.000 EUR), të cilat u përdorën për pagesa të kontratave të shërbimit të lidhura në funksion të ndërtimit që do realizonte. Një muaj pas nënshkrimit, marrëveshja u revokua nga të dyja palët.

Nga verifikimet e mëtejshme, shoqëria 'Beta' shpk ka marrë financime dhe hua të dyshimta nga palë të treta si vijon:

- 2.000.000 EUR total, nga 2 shoqëri 'Gama' shpk (1.5 milion EUR) dhe 'Zeta' shpk (500.000 EUR) që operojnë në fushën e tregtisë;
- 200.000 EUR nga subjekti tregtar 'Mega' shpk, e zotëruar 100% nga shtetasi B;
- 200.000 EUR nga tre shtetas të ndryshëm, dhënë në formë huaje;
- 800.000 EUR nga një shtetas shqiptar "X" më të cilin kishte lidhur një kontratë huaje.

Fondet e dhëna hua (prej 800.000 EUR) nga shtetasi 'X' ishin përfituar nga shitja e dy pasurive të paluajtshme tek blerësja 'Y', bashkëshorte e një personi me precedentë kriminal. Në lidhje me shtetasin 'X' u zbuluan se kishte lidhje të ngushta miqësore me shtetasin B (vëllai i ortakës së vetme të shoqërisë 'Beta' shpk) i dyshuar se është pronari dhe financuesi real i shoqërisë së ndërtimit.

Të gjitha këto fonde (3.2 milion EUR) u përdorën nga 'Beta' shpk për pagesë takash të lidhura me procesin e ndërtimit.

Bazuar në dyshimet:

- Vlerën e lartë të investimit dhe mungesa e kapaciteteve ekonomike të shoqërisë 'Beta' shpk;
- Sigurimin e dyshimtë të fondeve nga palë të treta për kryerjen e investimit;
- Lidhjet me persona me precedentë kriminal;

rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Tipologji 3: Hua dhe sponsorizime të dyshimta nga një PEP


Në gusht 2021, shtetasi A me profil biznesmen, i dha hua shumën 70.000 USD një funksionari shtetëror shtetasi B, i cili e ka garantuar shlyerjen e huasë me hipotekimin e një pasurie të paluajtshme të llojit truall në pronësi të tij. Në burime të hapura informacioni ka të dhëna se shtetasi A është arrestuar disa vite më parë i akuzuar për vepra penale në fushën fiskale. Gjithashtu u konstatua një lidhje indirekte (konflikt interesi) ndërmjet objektit të veprimtarisë së subjektit tregtar të shtetasi A dhe fushës së veprimtarisë së institucionit ku ushtron detyrën shtetasi B.

Në shtator 2021, shtetasi B i ka tërhequr cash fondet e marra hua (70.000 USD) nga llogaria e tij bankare dhe ia ka dhënë cash (dorazi) një të afërmit të tij pensionist, shtetasi X në formë mbështetje financiare. Ky i fundit, brenda të njëjtës ditë i ka depozituar fondet në llogarinë bankare të një shoqërie ndërtimi me të cilën disa muaj më parë, shtetasi X kishte lidhur një kontratë porosie me qëllim blerjen e një njësie tregtare në Tiranë. Vlera e kontratës është 150.000 USD dhe palët kanë rënë dakord që pagesa e vlerës totale të pasurisë të bëhej me këste.

Bazuar në dyshimet:

- Natyra e paqartë e huasë së marrë me qëllim investimin në pasuri të paluajtshme nga persona të tretë të lidhur me PEP;
- Lidhjen e paqartë mes palëve të përfshira në këto transaksione;

rasti është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.



Tipologji 4: Blerje pasurish të paluajtshme nën vlerë dhe rivlerësim brenda një kohe të shkurtër

Në shkurt 2021, shtetasi A (i cili zotëron një biznes të llojit person fizik) ka blerë një pasuri të paluajtshme të llojit truall me sipërfaqe 1,500 m², me çmim 30,000 USD. Dy muaj më pas, shtetasi ka bërë fillimisht rivlerësimin e pronës² në vlerën 240,000 USD dhe më pas ia ka shitur truallin një biznesmeni që operon në fushën e ndërtimit me të njëjtin çmim (240,000 USD).


Pra brenda 2 muajsh, pronën e blerë për vetëm 30,000 USD e ka shitur me një çmim tetë herë më të lartë, ndërkohë që nga verifikimet e kryera nuk rezultoi që mbi këtë truall të ishte realizuar investim, i cili mund të kishte rritur vlerën e pasurisë.

Gjithashtu në vijim, në prill 2021 shtetasi A mori hua 80,000 EUR nga shtetasi B (i angazhuar në aktivitetet privat në fushën e shërbimeve), me qëllim blerjen e një pasurie të luajtshme (automjet). Shtetasi B i ka gjeneruar fondet e dhëna hua nga shitja e një pasurie të paluajtshme të llojit 'tokë arë me sipërfaqe 30,000 m², tek blerësi shtetasi C (biznesmen në fushën e ndërtimit) me çmim 150,000 EUR. Pas marrjes së huasë, shtetasi A ka blerë një autoveturë me çmim 80,000 EUR tek shtetasi C dhe disa ditë më vonë ia ka shitur mjetin shtetasit B, tek i cili u financua më herët me hua.

Nga sa më sipër, duke marrë në konsideratë:

- Shitjen e pasurisë së llojit 'truall' me një çmim 8 herë më të lartë nga çmimi i blerjes;
- Kompleksitetin e transaksioneve të ndërsjella mes tre palëve, ku fillimisht shtetasi B i shet truall shtetasit C dhe një pjesë të fondeve të përfituara (80,000 EUR) ia jep hua shtetasit A i cili i përdor këto fonde për blerje autoveture tek C dhe më pas autoveturën ia shet B;
- Rezultatet financiare të shtetasit A dhe familjarëve të tij, nuk i justifikojnë shumat e larta të qarkulluara prej tij;

rasti është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.



2 Bazuar në ligjin nr. 90/2019 'Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme' (ndryshuar me ligjin nr. 91/2020, datë 9.7.2020), në të cilën parashikohet se tatimi që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi është 3 % e bazës së tatueshme, në vend të 15%, pa këtë ligj të cituar.

Tipologji 5: Rast mashtrimi financiar kryer nga një subjekt juridik

Kompania 'X' është regjistruar në vendin tonë në mars 2021, nga shtetasit e huaj A dhe B (*që zotërojnë nga 50% të kuotave*) dhe objekti i saj i veprimtarisë konsiston në ofrimin e shërbimeve në fushën e informatikës. Disa ditë mbas themelimit të saj, shoqëria ka çelur llogari në 4 banka tregtare që operojnë në vendin tonë.

Nga analizimi i aktivitetit bankar të shoqërisë, u evidentuan disa transferta në mbërritje me anomali dhe jo në përputhje me profilin e aktivitetit të shoqërisë.

Këto transferta të dërguara nga shtete të ndryshme të Evropës si Kroaci, Rumani, Bullgari, Qipro, Austri, Poloni, Gjermani, Danimarkë, Francë, Spanjë, Mbretëri e Bashkuar etj.

- Janë të dërguara nga subjekte tregtare të ndryshëm me përshkrim 'likuidimi faturash';
- Janë të përqendruara më së shumti në periudhën Korrik – Nëntor 2021;
- Janë në vlera pothuajse të njëjta dhe luhaten në kufijtë 2,000 EUR – 2,500 EUR;


Nga verifikimet të mëtejshme, shoqëria 'X' nuk rezultoi të kishte deklaruar aktivitetet gjatë kësaj periudhe.

Mbështetur në sa më sipër, u kryen kërkime të tjera, nga të cilat rezultoi se:

- Për një pjesë të konsiderueshme të transfertave në mbërritje në favor të kësaj shoqërie, ka patur njoftime/raportime për kthimin mbrapsht të fondeve, të denoncuara si mashtrime nga ana e dërguesve të transfertave.
- Në burime të hapura, një nga ortakët e shoqërisë 'X' rezultoi të ketë qenë i përfshirë edhe në një skemë abuzimi në fushën fiskale/tregtare.
- Gjithashtu një organizatë ndërkombëtare kishte raportuar raste mashtrimesh të kryera nga disa kompani ndër to edhe emri i kompanisë 'X'. Skema e përdorur është paraqitja e faturave fiktive 'klientëve' /'viktimave' kundrejt shërbimeve të ndryshme në fushën e informatikës .
- Nga krahasimi i faturave fiktive u vu re se janë të njëjta me fatura përdorura nga kompania 'X'.

Bazuar në dyshimet e mësipërme informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit dhe njëkohësisht është nxjerrë urdhër bllokimi nga DPPPP e shoqëruar më tej me sekuestro të fondeve.

Skema 5:



Tipologji 6: Përdorimi i personave të tretë për investime në fushën e ndërtimit

Shtetasi A i cili për një periudhë të gjatë kohore prej rreth tetë vitesh ishte i punësuar me detyrë magazinier me një pagë minimale në një subjekt tregtar u përfshi si ortak në dy kompani në fushën e ndërtimit.

Konkretisht ky shtetas në vitin 2018 bleu 50% të kuotave të shoqërisë 'X' në vlerë 900.000 EUR duke deklaruar se pagesa do të realizohej nga fitimet e ardhshme të shoqërisë ku kishte bleu aksionet. Në lidhje me profilin e shoqërisë X rezultoi të jetë e njohur në tregun vendas prej 20 vitesh me deklarime të larta fitimesh.

Një vit më vonë shtetasi A bleu 100 % të kuotave në një shoqëri tjetër ndërtimi 'Y', në vlerë 150.000 EUR. Pak muaj para blerjes së kuotave nga shtetasi A, kjo shoqëri ('Y') kishte fituar leje për ndërtimin e një kompleksi pallatesh edhe pse në vitet e fundit kishte deklaruar humbje financiare.


Pas blerjes së kuotave të shoqërive të ndërtimit u vu re se ky shtetas përfitonte paga gjithmonë e më të larta nga shoqëritë X dhe Y që arrinin deri në 10.000 EUR në muaj edhe pse shoqëria e dytë ('Y') vazhdonte të deklaronte humbje.

Nga ana tjetër përveç investimeve në biznese, shtetasi A së bashku me bashkëshorten e tij shtetasen B gjatë një periudhe prej dy vjeçare, investuan në pasuri të paluajtshme (njësi, truall, vilë) shumën prej 3 milion EUR, nga të cilat një pjesë e mbuluar me kredi bankare.

Bazuar në dyshimet:

- Investimet në vlera të larta në biznese dhe në pasuri të paluajtshme nga një individ pa një profil të mëparshëm biznesi;
- Burimi i panjohur i fondeve të investuara;
- Përdorimi i kredive dyshuar si fasadë për pagesa investimesh pasuri të paluajtshme si vilë etj.;
- Mundësia që ky shtetas po përdorej nga persona të tjerë për investimin e fondeve të tyre; rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Skema 6



Tipologji 7: Këmbimi i pasurive dhe përdorimi i dyshimtë i kredive

Në vitin 2021 shtetasja A (bashkëjetuese e shtetasit B) dhe shtetasi B (ish PEP) kanë lidhur një kontratë noteriale me një kompani ndërtimi për shkëmbim të 2 pasurive të paluajtshme të llojit apartament në emër të përbashkët të tyre me një vilë në një kompleks ndërtimor në një zonë të njohur rezidenciale.

Apartamentet (sipërfaqe totale prej 130 m²) me të cilat u këmbyen ndodheshin në një zonë periferike të blera dy vite më parë ndërsa shtetasi B ishte ende në detyrë. Vlera e deklaruar e blerjes së tyre ishte 80,000 GBP, ku 80% e shumës e financuar me kredi bankare dhe pjesa tjetër nga kursimet. Pas blerjes apartamentet u rivlerësuan me vlerë tregu 110.000 GBP.

Në kuadër të këtij shkëmbimi pasurish midis shtetasve A, B dhe shoqërisë së ndërtimit ishte rënë dakord që do të paguhej vlera shtesë prej 120.000 GBP, e cila do të mbulohej me marrjen e një kredie bankare me këst mujor 1.000 GBP.


Ndërkohë vila e përfituar nga këmbimi me një sipërfaqe 350 m² u vendos kolateral në funksion të marrjes së kredisë së re dhe u vlerësua sipas çmimit të tregut 400.000 GBP.

Nga verifikimet e kryera mbi burimin e fondeve të tyre, u vunë re rënie të ardhurave personale dhe të aktivitetit tregtar të bashkëjetueses së shtetasit B.

Bazuar në dyshimet:

- Përfitimi nëpërmjet këmbimit të një pasurie të paluajtshme nën çmimin real të tregut;
- Përdorimi e instrumentit të kredisë e njohur edhe si tipologji në rastet investimeve nga PEP/ish PEP me qëllim mbulimin e burimit real të fondeve ;
- Mos justifikimi i pagesave të kësteve të larta të kredisë, nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre. rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Skema 7



Tipologji 8: Investim në vlerë të lartë në pasuri të paluajtshme në mënyrë jo të drejtpërdrejt

Shtetasja X e moshës 80 vjeç në cilësinë e palës blerëse ka nënshkruar, një kontratë për blerje pasurie të paluajtshme në vlerën 2.000.000 EUR. Nga verifikimet e kryera shtetasja X rezultoi të ishte e afërmja e shtetasit Y-ish funksionar i lartë publik (PEP).


Në lidhje me mënyrën e pagesës rezultoi se, çmimi total i blerjes do të mbulohej nga shoqëria 'DX' e cila nga ana e saj për pagimin e kësaj vlere, kishte marrë kredi pranë bankës 'AEF'.

Në marrëveshjen midis palëve, pas shlyerjes së plotë të detyrimit, shtetasja X do të kryente më tej procedurat për kalimin e pronësisë në favor të shoqërisë 'DX'.

Nga verifikime të mëtejshme të kryera rezultoi se ortak në shoqërinë 'DX' ishte një shtetas i quajtur F, për të cilin rezultonte i regjistruar një procedim penal, si dhe indicie negative në burimet e hapura për veprimtari kriminale. Indiciet e administruara nga burimet e hapura, tregonin për lidhje midis shtetasit F dhe ish-funksionarit Y, përforcuar dhe nga një kontratë huaje e lidhur paraprakisht përmes dy shoqërive (shoqëria 'EX' e shtetasit F dhe shoqëria 'LM' të shtetasit Y) të zotëruara prej tyre .

Bazuar në dyshimet:

- Investimin në pasuri të paluajtshme, në vlera të larta të pajustificuara;
 - Përfshirja e personave me precedentë kriminalë;
 - Përdorimi i personave të tretë si shtetas X , e afërme e një PEP;
- rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.



Tipologji 9: Transaksione të dyshimta nga subjekte juridike në fushën e mjekësisë

Shtetasi X djali i shtetasit Y ish PEP, në vitin 2016 ka themeluar në një nga vendet e rajonit shoqërinë “Alpha” me objekt veprimtarie: “Tregti e pajisjeve”. Që në ditët e para të themelimit shoqëria “Alpha” lidhi një kontratë me objekt “Shitjen e pajisjeve” në vlerën 2.000.000 USD me Laboratorin Mjekësor “AB” që operonte në të njëjtin shtet me shoqërinë “Alpha”.

Në marrëveshje midis palëve u ra dakord që pagesa të kryhej me këste duke aplikuar normë interesi dhe duke bërë që vlera totale që duhej paguar nga Laboratori Mjekësor “AB” kundrejt shoqërisë “Alpha” të ishte 4.000.000 USD, pra 2 fish i vlerës së pajisjeve.

Gjatë një periudhe kohore prej 6 vitesh shoqëria “Alpha” ka përfituar në kuadër të kësaj kontrate, nëpërmjet transfertave të shumta mujore të gjithë shumën 4.000.000 USD. Vlera e përfituar është përdorur për transfertat drejt:


- kompanisë “Alpha-S” e regjistruar po në të njëjtin vend si shoqëria “Alpha” dhe me ortak shtetasin Z
- llogarisë personale të shtetasit X në Shqipëri me përshkrim ‘dhënie huaje’ apo ‘kalim dividendi’,
- pagesa për udhëtime;
- pagesa faturash në vlera të ulta për subjekte të ndryshme në vendin tonë ;

Nga verifikimet rezulton se shoqëria “Alpha”, nuk ka kryer asnjë import për pajisjet e shitura dhe nga librat e shitblerjes rezulton që produktet të jenë blerë në vlerë totale 2.000.000 USD nga dy subjektet si më poshtë:

- Shoqëria “AT” e cila ka patur bashkëpunim të mëparshëm me Laboratorin Mjekësor “AB” (paguar sipas faturave 1.500.000 USD);
- Shoqëria “Alpha-S”, ortaku i të cilës shtetasi Z ka pasur bashkëpunime të mëparshme me Laboratorin Mjekësor “AB”;

Bazuar në faktin se një subjekt tregtar pa eksperiencë në fushën përkatëse, në pronësi të afërmit të ish PEP, blen pajisje nga dy shoqëri furnitore për t’ia shitur më pas një subjekti tregtar tjetër me çmim dy herë më të lartë, ndërkohë që pajisjet mund të bliheshin drejtpërdrejt nga ky i fundit, lindën dyshime se këto transaksione kanë për qëllim mbulimin e fondeve të dyshimta të gjeneruara në Shqipëri, për rrjedhojë informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet ligj zbatuese.

Skema 9:



Tipologji 10: Investime në pasuri nga PEP me vlerë të deklaruar nën çmim tregu

Shtetasja X ka ushtruar detyrën si PEP në fushën e drejtësisë për një periudhë të gjatë kohore. Në lidhje me këtë shtetase nga burime të hapura rezultojnë të dhëna për veprimtari të mundshme korruptive gjatë ushtrimit të detyrës.

Nga ana jonë u kryen verifikime të mëtejshme në lidhje me të dhe familjarët e saj nga sa rezultoi se:

- Shtetasja X për një periudhë të gjatë kohe rreth 12 vjet, nuk e tërhiqte apo përdorte për shpenzime pagën e saj, të përfituar nga pozicioni si PEP por e investonte atë në depozita me afat duke akumuluar rreth 130.000 EUR;
- Kjo shtetase në llogari të saj personale kishte kryer depozitime cash në vlera që variojnë nga 3.000 EUR deri në 30.000 EUR, të deklaruara si të ardhurave nga biznesi familjar;
- Bashkëshorti e saj rezultoi me pagë minimale si i vetëpunësuar pranë biznesit familjar ndërsa fëmijët ishin përfshirë në marrëdhënie punësimi vetëm vitet e fundit.

Gjithashtu bashkëshorti i shtetasës X, gjatë këtyre viteve kishte kryer investime në disa pasuri të paluajtshme (sipërfaqe toke) të blera fillimisht me vlerë të ulët krahasuar me çmimin e tregut për të lidhur më pas kontrata sipërmarrje për kryerjen e ndërtimeve rezidenciale, nga e cila do të përfitonin 50% të sipërfaqes së ndërtimit.


Nga verifikimi për bizneset e deklaruara rezultoi se bashkëshorti i saj kishte regjistruar dy subjekte tregtare të llojit ‘Person fizik’, në të cilat herë pas here kryheshin investime/rregullime të për zgjerim aktiviteti. Për bizneset janë deklaruar fitime vjetore në vlera që variojnë nga 400.000 LEK deri në 2.000.000 LEK. Në llogaritë e këtyre bizneseve nuk ka qarkullime fondesh të tilla për të justifikuar aktivitetin e tyre.

Bazuar në dyshimet:

- Depozitat e krijuara nga mos përdorimi ndër vite i pagës,
- Depozitimet e pajustificuara me para në dorë në llogari personale;
- Investimet e kryera në sipërfaqe toke me vlerë të ulët, me qëllim dhënien e tyre për ndërtim, skemë kjo e njohur në fushën e pastrimit të parave;

rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Skema 10



NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE DHE ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË

Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese

Trajnimi i subjekteve të ligjit është një ndër detyrat funksionale të DPPPP dhe në këtë kuadër, gjatë vitit 2021, janë organizuar një numër i konsiderueshëm trajnimesh (kryesisht në formë elektronike si pasojë e pandemisë) të kategorive të ndryshme të subjekteve të ligjit si: Banka, IFJB, Zyra Këmbimi Valutor dhe agjentë të transferimit të parave, SHKK, Shoqëri Sigurimesh, Fonde Pensioni, Noter, Avokat, Kontabilist, Shoqëri ndërtimi, Agjenci Udhëtimi etj.

Ky aktivitet intensiv është bazuar në një plan vjetor në të cilin janë identifikuar aspektet kryesore duke vënë në mënyrë të veçantë theksin tek zbatimi efektiv i sanksioneve ndërkombëtare për personat e shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, adresimin e rekomandimeve të Komiteti Moneyval të KiE dhe institucioneve të tjera monitoruese, vlerësimin individual të riskut nga subjektet dhe kategorizimin e klientëve të tyre mbi bazën e këtij vlerësimi, zbatimin efektiv të vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar ndaj klientëve,

ndryshimet në legjislacionin PP/FT, analizimi dhe raportimi i transaksioneve komplekse tipologjitë dhe treguesit etj.

Krahas organizimit të seancave individuale të trajnimit, DPPPP ka vijuar bashkëpunimin dhe me autoritete mbikëqyrëse dhe licencuese, me qëllim që të prezantohet sa më mirë përvoja parandaluese e institucioneve si dhe të vlerësohet niveli i përputhshmërisë së subjekteve me legjislacionin PP/FT.

Nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit, është synuar që efekti i tyre të ketë një shtrirje sa më të gjërë të subjekteve, veçanërisht në ato që kategorizohen me risk të mesëm dhe të lartë dhe numri total i personave të trajnuar është 870.

Në tabelën vijuese, paraqiten të dhënat periodike, në lidhje me numrin e personave të trajnuar sipas subjekteve të ligjit.

Tabela 7: Numri i personave të trajnuar në subjekte për periudhën 2017 – 2021.

Subjekti	Nr. i personave të trajnuar				
	2017	2018	2019	2020	2021
Banka	364	203	208	57	4
ZKV/dhe ose agjentë të transferimit të parave	35	73	267	492	42
Shoqëri Transfertash	-	-	6	-	-
IFJB	115	126	7	146	24
Shoqëri ndërmjetësimi	-	3	-	-	-
Lojëra Fati	3	1	-	-	1
Noterë/avokat	30	221	72	1,167	199
Auditues Ligjor	3	2	114	154	26
Shoqëri Sigurimi jete, broker	1	2	35	66	1
Autoritete Mbikëqyrëse dhe Institucione	27	24	20	354	5
Shoqëri tregtimi të automjeteve	3	-	10	19	-
OJF	-	-	48	-	2
Shoqëri ndërtimi	14	18	13	453	18
Shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të fondeve të pensionit	1	0	8	40	-
Agjentë të pasurive të paluajtshme	-	29	-	41	6
Agjensi udhëtimi	-	-	-	14	1
SHKK	-	-	-	16	1
Kontabël i miratuar	-	-	-	-	540
Totali	596	702	808	3,016	870

Gjatë vitit 2021 nga ana e DPPP janë organizuar trajnime me prani fizike në baza javore. Në këto seanca janë trajnuar 330 persona përfaqësues të subjekteve të ligjit, ndërsa online janë trajnuar 540 “Kontabilistë të Miratuar” dhe “Ekspertë Kontabël”.

Një rol të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve parandaluese, luan gjithashtu dhe inspektimi në vend apo në distancë i subjekteve nga ana e DPPP, i cili krahas kontrollit për zbatimin e detyrimeve ligjore, ofron dhe ndihmesë në drejtim të zbatimit të ligjit në vijimësi, duke e konkretizuar atë dhe me rastet praktike të punës së tyre.

Analizimi i përputhshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë

Përputhshmëria e subjekteve raportuese me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e PP/FT, përbën një ndër objektivat kryesorë të veprimtarisë së DPPPPP.

Për të siguruar një nivel në rritje të efektivitetit procesit të mbikëqyrjes së përputhshmërisë, puna e drejtorisë është përqendruar në ato kategori subjektsh, të cilat paraqesin një nivel të mesëm apo të lartë të riskut PP/FT.

DPPPPP gjatë vitit 2021 edhe pse në kushtet dhe rrethanat anormale të krijuara nga situata e pandemisë, ka mbajtur në vëmendje të vazhdueshme

rritjen e efikasitetit të punës, në sajë të përdorimit efektiv të burimeve njerëzore dhe logjistike me qëllim që të sigurojë një ndikim sa më të gjerë në nivelin e përputhshmërisë së subjekteve.

Koordinimi dhe bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, ka qenë një nga shtyllat kryesore dhe për këtë qëllim janë realizuar një sërë inspektimesh të përbashkëta në subjektet financiare në bashkëpunim me BSH, në shoqëritë e sigurimit të jetës dhe depozitarëve në bashkëpunim me AMF.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për inspektimet në vend dhe në distancë të vitit 2021, të krahasuara me periudhat pararendëse.

Tabela 8: Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2017-2021:

Nr	Subjektet e Inspektuara	2017		2018		2019		2020		2021	
		Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë
1	Banka	5	2	7	7	5	5	-	-	5	-
2	IFJB	5	-	7	-	3	7	5	5	7	5
3	Shoqëri ndërmjetësimi	1	-	3	-	-	-	-	-	-	-
4	ZKV	18	27	19	20	16	4	20	38	4	20
5	Ekspertë kontabël	3	9	2	11	10	-	-	8	-	-
6	Shoqëri ndërtimi	14	19	9	14	13	9	14	16	9	14
7	Mjete motorike	-	5	-	-	-	-	-	1	-	-
8	Noterë	6	17	10	39	11	7	31	38	7	31
9	Lojëra Fati	3	3	1	-	-	-	-	-	-	-
10	Sigurim jete dhe ri-sigurim	1	-	2	-	-	1	-	-	1	-
11	Studio Ligjore	-	15	3	-	-	9	19	16	9	19
12	Shoqëri të kursim kreditit	1	-	-	-	-	-	-	3	-	-
13	Metale të çmuara	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-
14	Agjensi të pasurive të paluejtshme	3	5	-	19	1	-	-	-	-	-

15	Fonde Investimi/ Pensioni/ Depozitarë	1	-	1	-	3	-	-	-	-	-
16	Agjenci Udhëtimi	1	6	-	8	-	-	1	1	-	1
17	Shërbime postare që kryejnë shërbime pagesash	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shuma		63	108	64	118	62	42	90	126	42	90
TOTALI		171		182		176		167		132	

Numri total i inspektimeve në vend për vitin 2021 ashtu si në vitin 2020 është më i ulët se vitet e kaluara. Rënia e numrit të inspektimeve në vend vjen si pasojë e situatës së krijuar dhe masave kufizuese kundër pandemisë.

Gjatë kësaj periudhe i është kushtuar vëmendje e veçantë bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse dhe informimi i tyre në rrugë shkresore mbi veprimtarinë e DPPPP, rekomandimet e FATF dhe efektivitetin e mbikëqyrjes së subjekteve mbi bazën e riskut. DPPPP ka vijuar t'i kushtojë vëmendje të veçantë inspektimeve të përbashkëta³ me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, të cilat në vitin 2021 përbëjnë 36% të totalit të inspektimeve në vend.

Bashkëpunimi me këto autoritete, ka një rol në rritje në drejtim të përdorimit efektiv të burimeve njerëzore të DPPPP, shkëmbimit të eksperiencës institucionale, harmonizimit të programeve të mbikëqyrjes dhe orientimit të punës sipas nivelit të kategorizimit të riskut të subjekteve të ligjit.

Gjatë këtij viti, DPPPP është përqendruar në inspektimet në subjektet me risk të lartë⁴ të cilat në total janë 102 (77% të totalit të inspektimeve), ndërkohë që në pjesën e mbetur përfshihen subjekte me risk të mesëm dhe të ulët.

³ Nga 42 inspektime në vend, 15 prej tyre janë realizuar me BSH (4) me AMF (4), Dhoma Kombëtare e Avokatisë (5) dhe me BMP (2).

⁴ Kategoritë dhe numri i inspektimeve respektive (Banka 5, IFJB 12, ZKV 24, Shoqëri ndërtimi 23 dhe noter 38)

Nga inspektimet e realizuara në 2021, janë konstatuar mangësitë e mëposhtme për të cilat janë propozuar dhe masa administrative.

- Mos raportimi i transaksioneve të kryera në para fizike mbi pragun e përcaktuar në ligj, megjithëse rastet janë sporadike dhe në ulje;
- Nuk është kryer monitorim i duhur marrëdhënies së biznesit me klientin;
- Nuk është mbajtur një sistem i përshtatshëm i centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave;
- Mos kryerja e analizave të thelluara për transaksionet komplekse, në vlera të larta, të pazakonta dhe të pa justifikuara nga pikëpamja ekonomike;
- Mangësi në organizimin e trajnimeve të punonjësve dhe në përditësimin e rregulloreve apo procedurave të brendshme me ndryshimet ligjore;
- Mos regjistrimi në modulën e raportimit duke sjellë pamundësinë për tu njohur me listat e PEP dhe personave të shpallur si financues të terrorizmit;
- Është propozuar Ministrisë së Drejtësisë, çrregjistrim i përmbaruesve të cilët nuk kanë dërguar informacion sipas kërkesës për informacion.

Për këto mangësi, DPPPP ka vijuar procesin e shqyrtimit të shkeljeve të evidentuara, ka bërë rekomandimet përkatëse për subjektet dhe njëkohësisht ka vënë në dijeni autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese.

MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESET GJYQËSORE

Masat administrative

Gjatë vitit 2021 janë evidentuar subjekte që nuk përmbushin nivelin e duhur të përputhshmërisë me kuadrin rregullator për PPP/FT, për të cilët ka vijuar procesi i shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative deri në dhënien e vendimit të arsyetuar me masë administrative “gjobë” apo “paralajmërim”, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.

Përveç inspektimeve në vend, janë vlerësuar edhe praktika të mbikëqyrjes në distancë nëpërmjet

Raporteve të Vetëkontrollit apo indicie nga monitorimi në distancë i subjekteve të ligjit për shkelje të detyrimeve ligjore, të cilat zënë edhe peshën kryesore, krahasuar me inspektimet në vend.

Gjatë këtij viti janë marrë në shqyrtim nga Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative gjithsej 54 subjekte, të ndara sipas kategorive të subjekteve.



Tabela 9: Kundërvajtjet administrative të shqyrtuara sipas kategorive të subjekteve

Subjektet	Nr. shqyrtimeve
Bankë	1
IFJB	3
ZKV	11
Noter	25
Studio ligjore	4
Shoqëri ndërtimi	10
TOTAL	54

Në përfundim të shqyrtimit të procedurave administrative DPPP ka konkluduar me dhënien e masës administrative “Gjobë” për 23 subjekte, masë administrative “Paralajmërim” për 10 subjekte, ku vlen të përmendet se për 1 subjekt përveç masës “Paralajmërim” është marrë edhe vendimi për “Shpallje publike të kundërvajtësit”. Ndërkohë, DPPP ka konkluduar me vendimmarrje “Pushim i procedimit administrativ” për 21 subjekte.

Tabela 10: Masat administrative të dhëna sipas kategorisë të subjekteve

Subjektet	Masa administrative “Gjobë”	Masa administrative “Paralajmërim”	Vendim Pushimi	Nr. i shqyrtimeve sipas subjekteve
Bankë	-	1	-	1
IFJB	1	-	2	3
ZKV	4	4	3	11
Noter	12	3	10	25
Studio ligjore	-	2	2	4
Shoqëri ndërtimi	6	-	4	10
TOTAL	23	10	21	54

Minimumi i gjobës së aplikuar për vitin 2021 ka qenë 100,000 lekë dhe maksimumi 2,000,000 lekë. Vlera totale e gjobave të vendosura është 8,200,000 lekë.

Peshën kryesore nga subjektet e gjobitura e zënë shoqëritë e ndërtimit ndaj të cilave janë aplikuar 6 masa administrative me vlerë 3,800,000 lekë, 12 masa administrative me vlerë 3,000,000 lekë për subjektet “Noter” dhe 4 masa administrative në vlerën 1,100,000 lekë për ZKV.

Tabela 11: Vlera e masave administrative sipas subjekteve.

Subjektet	Nr. i subjekteve	Vlera e masave administrative në Lekë
IFJB	1	300,000
ZKV	4	1,100,000
Noter	12	3,000,000
Shoqëri ndërtimi	6	3,800,000
TOTAL	23	8,200,000

Masat administrative të vendosura në raport me inspektimet e kryera kanë pësuar ulje, element ky përgjithësisht tregues i rritjes së masave të sistemit parandalues në vend nga ana e subjekteve, ndërgjegjësimit si dhe efikasitetit të reagimit ndaj sfidave të përbashkëta.

Tipologjia e kundërvajtjeve administrative të konstatuara për subjektet e ligjit konsiston kryesisht në shkelje të kategorizuara në grupime si më poshtë:

- Mos raportim të transaksioneve në para fizike mbi pragun ligjor parashikuar nga neni 12 pika 3, ligji nr. 9917/2008, i ndryshuar.
- Moszbatim i detyrimit për kryerjen e vigjilencës së duhur parashikuar nga nenet 4, 4/1 dhe 5, ligji nr. 9917/2008, i ndryshuar.
- Moszbatim të detyrimit për kryerjen e vigjilencës së zgjeruar, parashikuar nga neni 8 pika 7, ligji nr. 9917/2008, i ndryshuar.
- Moszbatim të detyrimeve që burojnë nga neni 11, pika 1/c, ligji nr. 9917/2008, i ndryshuar.

Tabela 12: Të dhëna krahasimore të masave administrative “gjobë” për periudhën 2017-2021.

Subjekte	2017		2018		2019		2020		2021	
	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr.	Vlera
Banka	5	17,000,000	-	-	-	-	-	-	-	-
IFJB	1	500,000	-	-	1	500,000	1	600,000	1	300,000
ZKV	8	3,600,000	3	1,100,000	1	500,000	4	2,500,000	4	1,100,000
Noter	2	1,000,000	4	2,800,000	2	1,100,000	6	1,100,000	12	3,000,000
Lojëra Fati	1	500,000	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëri Ndërtimi	9	6,000,000	10	9,800,000	5	3,000,000	3	2,200,000	6	3,800,000
Shoq. tregimit të mjeteve motorike	-	-	1	500,000	1	600,000	1	1,000,000	-	-
TOTALI	26	28,600,000	18	14,200,000	10	5,700,000	15	7,400,000	23	8,200,000



Ekzekutimi i masave administrative dhe proceset gjyqësore

Gjatë vitit 2021, nga 23 masa administrative “gjobë” të vendosura, 16 prej tyre janë arkëtuar, me marrjen e vendimit nga ana e subjekteve, 2 prej tyre kanë lidhur marrëveshje për pagesë me këste, ku arkëtimi për masat e këtij viti arrin në shumën prej 4,168,000 lekë.

Shuma prej 1,669,638 lekë është akumulim nga masat administrative me gjobë të dhëna gjatë viteve të kaluar dhe në proces ekzekutimi.

Tabela 13: Të dhënat krahasimore të arkëtimeve për periudhën 2017 – 2021

Zërat	2017	2018	2019	2020	2021
Vendime për Gjoba	26	18	10	15	23
Shuma totale e gjobave Lek	28,600,000	14,200,000	5,700,000	7,400,000	8,200,000
Shuma totale e arkëtimit Lek	27,788,000	22,590,643	5,018,000	6,313,000	5,837,638

Për të rritur efikasitetin e ekzekutimit të masave administrative, DPPPP ka ndjekur me vëmendje fazat e ekzekutimit me zyrat përbarimore, duke rritur në këtë mënyrë edhe efikasitetin e kësaj veprimtarie, deri në përmbushjen e fazave të ekzekutimit të detyrueshëm.

Proceset gjyqësore

DPPPP i ka kushtuar vëmendje të veçantë ndjekjes së proceseve gjyqësore në lidhje me masat administrative të vendosura, nga ku çështje gjyqësore të përfunduara gjatë këtij viti me vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë janë gjithsej 9 (nëntë) çështje, si vijon:

- për 7 (shtatë) procese gjyqësore, Gjykata ka dhënë vendimin në favor të DPPPP;
- për 2 (dy) procese vendimet janë dhënë në favor të subjekteve.

Në Gjykatën Administrative të Apelit është shpallur vendimi për 2 (dy) çështje, për të cilat është vendosur rrëzimi i kërkesës së subjekteve, në favor të DPPPP.

BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave

Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP), si organi më i lartë përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, gjatë viti 2021 ka organizuar mbledhjen e radhës në datë 28.06.2021, me pjesëmarrjen e anëtarëve të KBLKPP si dhe të institucioneve pjesë e grupeve ndër-institucionale të punës për ndjekjen e ecurisë të zbatimit të Planit të Veprimit të ICRG/FATF (Shkurt 2020- Shkurt 2022). Mbledhja e organizuar pati në fokus prezantimin e rezultateve të arritura në zbatimin e “Planit të Veprimit” si dhe dakordësimin për përmbushjen brenda afateve të përcaktuara të çështjeve ende të paadresuara në zbatimin e këtij plani.

Bashkëpunimi kombëtar ndër-institucional

Përkushtim dhe angazhim maksimal është treguar përsa i përket koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional me institucione të tjera brenda vendit, jo vetëm në rolin e DPPPP si koordinatore e procesit të vlerësimit nga Moneyval dhe FATF, por edhe në kuadër të bashkëpunimit për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

DPPPP ka pasur një korrespondencë të vazhdueshme dhe intensive me DPPSH dhe Prokuroritë e vendit, për shkëmbim informacioni dhe reagimin në kohë dhe efektiv për rastet nën hetim apo procedim, veçanërisht për rastet e referuara nga DPPPP.


Gjatë vitit 2021, janë trajtuar 212 kërkesa për informacion të ardhura nga DPPSH me të cilat është kërkuar informacion për 2,342 persona. Nga prokuroritë e rretheve dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) kanë ardhur 634 kërkesa për informacion, me të cilat janë kërkuar të dhëna për 3,708 individë, ku DPPPP ka kryer verifikime dhe ka informuar në kohë këto institucione.



Tabela 14: Numri i kërkesave për verifikime nga DPSH dhe Prokuroritë dhe numri i personave të përfshirë për vitin 2021.


Institucioni	Nr. kërkesa	Nr. persona
Policia e Shtetit	212	2,342
Prokuroritë	634	3,708
TOTAL	846	6,050

Grafiku 2: Numri i kërkesave për verifikime dhe numri i personave të përfshirë ndër vite



Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e punës së DPPPP vijon të jetë shkëmbimi i informacionit me institucionet e tjera si: KPK, KJV, KLGJ, KLP, MEPJ, BSH, AMF, DSIK etj., kërkesa për të cilat DPPPP është impenjuar maksimalisht për të respektuar afatet ligjore të kthimit të përgjigjeve. Për vitin 2021, DPPPP ka marrë në total nga këto institucione 335 kërkesa me të cilat janë kërkuar të dhëna për 1,441 individ.

Grafiku 3: Numri i kërkesave për verifikime me institucione shtetërore dhe numri i individëve të përfshirë



Bashkëpunimi ndërkombëtar

Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare

Konferencë rajonale: Në datat 4-5 Nëntor 2021, Drejtori i Përgjithshëm i DPPPP ka marrë pjesë në konferencën rajonale të drejtuesve të Njërive të Inteligjencës Financiare (NjIF), zhvilluar në Beograd, Serbi. Në këtë konferencë u diskutua situata në lidhje me përputhshmërinë e sistemeve parandaluese në kuadër të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PPP/FT) me standardet ndërkombëtare, vlerësimet aktuale të risqeve të PP/TF, tipologjitë dhe tendencat në rajon, si dhe mënyra për të përmirësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet njërive të inteligjencës.



Forumi i Bashkëpunimit Financiar: Në datat 3-5 Nëntor 2021 u zhvillua në Monako Forumi i Bashkëpunimit Financiar midis NjIF-ve Frankofone të grupit Egmont në të cilin DPPPP u përfaqësua nga punonjës të Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë. Në këtë Forum morën pjesë përfaqësues nga përreth 30 NjIF partnere. Diskutimi i zhvilluar ishte gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues midis përfaqësive të shteteve pjesëmarrëse, ku fokusi u përqendrua në çështjet e PPP/FT për sigurinë dhe stabilitetin në botë, luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurisë kulturore, bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, tendencat kryesore të krimit financiar global, parandalimin e krimit financiar në garat sportive, sigurinë gjatë shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimi dhe transparenca tatimore, si dhe sfida që po përballen gjithnjë e më shumë shtetet në lidhje me ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale.

Forumi rajonal i Ohrit: Në datat 20- 23 Qershor 2021, Drejtori i Përgjithshëm i DPPPP ka marrë pjesë në Forumin rajonal të Ohrit. Ky forum është zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit tonë në periudhën e draftimit dhe finalizimit të Udhëzuesit kundër korrupsionit dhe financimeve të paligjshme në vendet e Ballkanit Perëndimor (the roadmap). Fokusi më i madh gjatë këtij Forumi ishte diskutimi dhe konsultimi i tematikave kryesore si: prokurimeve publike; rikuperimi i aseteve; krimi ekonomik dhe çështjet për parandalimin e pastrimit të parave.

Shkëmbimi i informacioneve me NjIF

Gjatë vitit 2021, DPPP ka shkëmbyer rregullisht informacion me NjIF partnere duke e konsoliduar gjithnjë e më shumë këtë bashkëpunim si një element kyç në mbarëvajtjen e punës së DPPP. Informacionet e shkëmbyera janë dërguar në një kohë të shpejtë dhe informacioni ka shërbyer për analizimin e rastit.

Vlen të përmendet që me disa prej NjIF partnere, në nivel evropian kemi pasur shkëmbime informacioni më të shpeshta dhe një bashkëpunim më të ngushtë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.


Gjatë vitit 2021 kemi shkëmbyer informacion me NjIF partnere në total për 163 raste nga të cilat 82 janë kërkesa dhe informacion spontan dhe 81 janë kthim përgjigje të DPPP.

Ndërkohë nga NjIF partnere gjatë vitit 2021 në total është shkëmbyer informacion për 178 raste nga të cilat 107 janë kërkesa dhe informacion spontan dhe 71 janë përgjigje të dërguara nga NjIF partnere.

Tabela 15: Numri i kërkesave dhe përgjigjeve me NjIF partnere ndër vite

Periudha	Kërkesa dhe informacion spontan		Përgjigje	
	Të dërguara nga DPPP	Të marra nga NjIF partnere	Të dërguara nga DPPP	Të marra nga NjIF partnere
2017	74	79	54	43
2018	103	97	64	77
2019	70	120	67	38
2020	91	113	70	67
2021	82	107	81	71

Grafiku 4: Shkëmbimi i informacionit me NjIF për periudhën 2017 – 2021



Procesi i vlerësimit nga Moneyval dhe FATF

Gjatë vitit 2021, vendi ynë ka vijuar në proces monitorimi të përforcuar nga Komiteti Moneyval, pjesë e KiE (Këshilli i Evropës) si dhe njëkohësisht në periudhë monitorimi nga ICRG/ FATF (Grup i posaçëm pune i FATF).

Dy proceset e vlerësimit/monitorimit, ai i Moneyval (teknikalitetit) dhe ICRG/FATF (efektivitetit), janë të ndërthurur me njëri tjetrin, burojnë nga i njëjti raport vlerësimi, por të pavarur mes tyre.

Procesi i vlerësimit nga Komiteti Moneyval i KiE

Shqipëria gjatë vitit 2021, për Komitetin Moneyval, dërgoi në muajin Tetor raportin e radhës, vlerësimi i të cilit pritet të miratohet gjatë vitit 2022 në plenaren e 63 të Komitetit Moneyval. Deri aktualisht Shqipëria ka të adresuara apo të adresuara gjerësisht 33 rekomandime të FATF nga 40 në total.

Në këtë raport pritet të konfirmohet rritje e vlerësimit për katër rekomandime të FATF, Rekomandimin 24 (transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridik), Rekomandimin 26 (rregullimi dhe mbikëqyrja e DFNPB/ bizneset dhe profesionet e caktuara jo financiare), Rekomandimin 28 (institucionet mbikëqyrëse dhe licencuese supervizorëve) dhe Rekomandimin 38 (ndihma e ndërsjellë juridike, bllokimet, sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive).

Procesi i vlerësimit nga ICRG/ FATF

Shqipëria vijon të jetë në proces monitorimi nga ICRG/ FATF, për pjesën e efektivitetit të sistemit shqiptar të parandalimit të pastrimit të parave. Shqipëria ka përgatitur dhe dërguar tre raporte për vlerësim në ICRG/ FATF, përkatësisht në muajt mars, gusht dhe dhjetor 2021.

Gjatë vitit 2021, u arritën rezultate domethënëse ku evidentohen kryesisht:

- Miratimi i ndryshimeve dhe shtesave në ligjin kuadër në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke e përafuar atë plotësisht me Direktivat e BE (direktiva 4 dhe 5) në këtë fushë dhe duke mundësuar në këtë mënyrë zbatimin e standardeve të njëjta me ato të vendeve evropiane.
- Prej Shtator 2021 ka filluar zbatimin i plotë i projektit të fiskalizimit, ku gjithnjë e më shumë po vërehet reduktimi i përdorimit të parasë fizike/ “cash” dhe ulje e ekonomisë informale.
- Është bërë i mundur regjistrimi i plotë i pronave urbane në Shqipëri dhe brenda dy viteve do të mundësohet digjitalizimi i plotë i të gjitha pronave në Shqipëri dhe në të njëjtin drejtim po shkohet për të mundësuar ofrimin e shërbimeve online për të gjithë qytetarët shqiptar, me qëllim mundësimin e të dhënave sa më transparente, të sakta dhe të aksesueshme në kohë reale.
- Është miratuar kuadri ligjor dhe janë në funksionim të plotë dy regjistrat, regjistri i pronarëve përfitues dhe regjistri i centralizuar i llogarive bankare. Të dy këto regjistra po i shërbejnë gjithnjë e më shumë sistemit parandalues për të identifikuar elementët kriminal për të identifikuar dhe gjeneruar në kohë reale informacion të plotë dhe të saktë për institucionet



ligj zbatuese Shqiptare.

- Është miratuar ligji i ri për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, me anë të të cilit është parashikuar ngritja e regjistrimit elektronik të OJFve (organizatave jo-fitimprurëse). Ngritja dhe funksionimi i këtij regjistri do të jetë një mekanizëm më shumë për transparencën e të dhënave në këtë sektor dhe që sigurisht do të shërbejë si një element mbështetës për rritjen e efikasitetit të sistemit parandalues.
- Institucionet mbikëqyrëse shqiptare për bizneset dhe profesionet e caktuara jo financiare po demonstrojnë gjithnjë e më shumë të kryejnë më mirë detyrat e tyre të evidentuara në planin e veprimit por edhe në funksion të detyrave të tyre funksionale gjatë proceseve të licencimit dhe mbikëqyrjes në përgjithësi.
- Shqipëria gjithashtu mbetet një aktore e besueshme në arenën ndërkombëtare si në zbatimin e rezolutave të këshillit të sigurimit (OKB) në lidhje me masat kundër financimit të terrorizmit si edhe në kuadrin e zbatimit të masave shtrënguese ndërkombëtare si të nivelit evropian dhe më gjerë.

Ndryshime ligjore

DPPPP gjatë vitit 2021 ka hartuar ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, të cilat u miratuan me Ligjin nr.120/2021 datë 02.12.2021 nga Kuvendi i Shqipërisë.

Ndryshimet ligjore të miratuara përafroan plotësisht ligjin 9917/2008 (i ndryshuar) me Direktivën (BE) nr. 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 20 maj 2015 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” e ndryshuar nga Direktiva (BE) 2018/843, të njohura ndryshe si Direktivat 4 dhe 5 AML.

Ndryshimet ligjore kryesore, konsistojnë në saktësimin e disa përkufizimeve ligjore, saktësimin e listës së subjekteve raportuese që i nënshtrohen ligjit, përcaktimin e disa të dhënave shtesë të nevojshme për t’u mbajtur dhe për t’u zbatuar nga subjektet raportuese ndaj klientëve në rastin e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar, parashikimin e masave të vigjilencës së zgjeruar në lidhje me marrëdhëniet e biznesit apo transaksionet që përfshijnë vendet me risk të lartë, qartësimin e afateve për mbajtjen e dokumentacionit nga subjektet raportuese, parashikimi i sanksioneve të mëtejshme administrative në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji.




BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TI

Buxheti dhe menaxhimi i tij


Gjatë vitit 2021, DPPP ka shpenzuar në total rreth 62,5 milionë lekë, ose 2.3 % më pak krahasuar me vitin 2020. Realizimi i shpenzimeve rezultoi në masën 79 % të fondit të buxhetuar.

Shpenzimet ishin të ndara në 79 milionë lekë shpenzime korrente dhe 2 milionë lekë shpenzime kapitale. Raporti i shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale, ndaj totalit rezultoi respektivisht 97,5 % dhe 2,5 %. Krahasuar me vitin 2020, kur struktura e shpenzimeve ishte 96,9 % korrente dhe 3,1 % kapitale, ka pasur një rritje të lehtë të shpenzimeve korrente dhe një vlerë të njëjtë të alokuar për shpenzime kapitale.


Shpenzimet korrente u realizuan në masën 77 % të planit. Një zë i veçantë në planifikimin e shpenzimeve për 2021 iu caktua edhe “Upgrade dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së TI”, por nisur nevojat e mëdha dhe nga vlerat relativisht të ulëta të fondeve në dispozicion, nuk u arrit të realizoheshin shpenzimet e planifikuara.



Grafiku 5: Fondet buxhetore të akorduara dhe përdorimi i tyre për periudhën 2017 – 2021.



Grafiku 6: Shpenzime korrente në dispozicion dhe përdorimi i tyre për periudhën 2017 – 2021.



Grafiku 7: Shpenzime kapitale (investime) në dispozicion dhe përdorimi i tyre për periudhën 2017 – 2021.

DPPPP do vijojë të jetë e angazhuar në menaxhimin aktiv të buxhetit, transparencën dhe përmirësimin e procesit të planifikimit, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike të akorduara, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës së TI, duke mundur zbatimin dhe arritjen e objektivave institucionale, në luftën kundër PP/FT.

Menaxhimi i burimeve njerëzore

Gjatë 2021, struktura organizative e DPPPP me një numër total strukturor prej 45 punonjësish ka pasur një realizim mesatar prej 90 %. Për këtë periudhë, në bashkëpunim me strukturat e DAP, janë realizuar procedurat e rekrutimit për plotësimin e 5 pozicioneve vakante të krijuara nga largimet me dëshirë gjatë vitit, në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij. Nga këto pozicione vakante, 4 kanë qenë rekrutime në nivel ekzekutiv dhe 1 pozicion në nivel drejtues.

Nëpërmjet strukturës përgjegjëse, janë mbikëqyrur dhe administruar burimet njerëzore, në zbatim të parimeve dhe kritereve të legjislacioni në këtë fushë, si dhe janë kryer proceset e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve, në përputhje me afatet ligjore.

DPPPP ka mundësuar rritjen profesionale të stafit dhe përfitimit të njohurive të reja në fushën e parandalimit të PP/FT, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të organizuara online për arsye të kushteve të diktuar nga pandemia.

Gjatë 2021, ka pasur një rritje të pjesëmarrjeve në trajnime online, ku 30 punonjës të DPPPP kanë qenë pjesëmarrës në 60 trajnime kryesisht online ku temat kryesore që janë trajtuar kanë qenë: Hetimi mbi monedhat virtuale, Kriptomonedhat




dhe monedhat numerike të bankave qendrore, Plani i implementimit të mbikëqyrjes së bazuar në risk, ‘Teknikat e hetimit financiar’, ‘Gjurmimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i Aseteve’, ‘Udhëzime dhe indikator për parandalimin e krimit kibernetik’, ‘Metodat dhe teknikat analitike për investigimin e PP/FT’, Prokurimi publik, etj.

DPPPP, në kuadër edhe të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë për arritjen e objektivave në luftën kundër PP/FT, do të vazhdojë të ndjekë politika prioritare për përmirësimin e kapacitetve profesionale, të bazuara jo vetëm në rritjen në numër të strukturës organizative por dhe në rritjen profesionale të stafit nëpërmjet ofrimit të mundësive dhe përfshirjes në trajnime.



Organigrama e DPPPP:





Teknologjia e informacionit

Rritja e kapaciteteve të TI, ka vijuar të jetë një nga aspektet prioritare të punës së DPPPP gjatë vitit 2021.

Sigurimi i mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së informacionit është realizuar në vijimësi në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë të specialistëve të TI në DPPPP, me kolegët e tyre të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, DPPSH, DSIK, DPD, DPT, ASHK, BSH, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe sektorit privat.

Të dhënat që raportohen nga subjektet e ligjit, zënë peshën kryesore të informacionit që mbledh dhe përpunon DPPPP dhe për këtë qëllim është punuar pa reshtur, për të realizuar funksionimin normal të moduleve të raportimit, duke ofruar një mbështetje të vazhdueshme teknike për këto subjekte si dhe për përdoruesit e një sërë institucionesh shtetërore.

Në sajë të këtij bashkëpunimi të vazhdueshëm, DPPPP ka arritur të siguroj një qasje normale në bazat e të dhënave të këtyre institucioneve për të mundësuar një analizë të gjithanshme dhe cilësore të informacionit, për çështjet e parandalimit PP/FT.

Investimet e realizuara në DPPPP, kanë qenë të fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe sistemeve të TI në DPPPP, ecurinë normale të raportimeve elektronike nga subjektet e ligjit,

modernizimi i pajisjeve, rritja e kapaciteteve të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Gjatë vitit 2021 ka vijuar konsolidimi i infrastrukturës së TI dhe është përgatitur dokumentacioni për ri-akreditimin e rrjetit informatik të DPPPP në zbatim të detyrimeve të VKM Nr.542, datë 25.7.2019, “Për miratimin e rregullores “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI).

Bashkëpunimi i DPPPP në nivel ndërkombëtar, ka diktuar nevojën e sigurimit të mbarëvajtjes së funksionit të mekanizmave të shkëmbimit të sigurt të informacionit me NjIF partnere, në funksion të të cilit është realizuar një mbikëqyrje e vazhdueshme, në përputhje me standardet dhe praktikën ekzistuese të grupit Egmont.

Mjetet e komunikimit elektronik janë përdorur gjerësisht për të informuar kategori të caktuara të subjekteve të ligjit, për çështjet që janë çmuar me risk të mesëm ose të lartë për PP/FT, në përputhje dhe me praktikën tashmë të konsoliduar në DPPPP nga vitet pararendëse.

Gjatë këtij viti vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore të Sektorit të TI, në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja normale e funksionimit të infrastrukturës së TI dhe përmbushjes së detyrave funksionale të institucionit.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2022

Përpjekjet dhe puna e kryer gjatë vitit 2021, do të shërbejë si pikënisje për çuarjen më tej të objektivave të vendosura në luftën dhe parandalimin e PP/FT. DPPPP mbetet e angazhuar për përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor, rregulloreve dhe procedurave si dhe proceseve të punës.

Përveç objektivave ligjor të DPPPP që janë pjesë e detyrave funksionale të institucionit, gjatë vitit 2022 vëmendje të posaçme do të ketë:

- Orientimi i mëtejshëm i procesit të përputhshmërisë sipas kategorizimit të riskut të subjekteve; dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese;
- Plotësimi në kohë dhe më cilësi i raportimit për ICRG dhe Moneyval;
- Konsolidimi i mëtejshëm i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës së TI;
- Rritja e nivelit të përputhshmërisë së subjekteve raportuese përmes organizimit të trajnimeve dhe fokusit në ato kategori të cilat paraqesin mangësi në këtë drejtim. Për këtë qëllim theksi do të vihet veçanërisht në zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare;
- Njohja me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe zbatimi i tyre në fushën e përputhshmërisë së subjekteve;
- Trajnimi i subjekteve të ligjit duke u fokusuar në ndryshimet e ligjit nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, vlerësimin e riskut PP/FT dhe zbatimin efektiv të sanksioneve ndërkombëtare;
- Angazhimi në projektet ndërkombëtare dhe kontributi në zbatimin e metodologjisë së KiE për Vlerësimin Kombëtar të Riskut;



ADRESA:

Ministria e Financave
dhe Ekonomisë
Blv. "Dëshmorët e
Kombit", Nr.3, Tiranë



KONTAKTE:

Tel: +355 42 24 4 602
Mail: info@fint.gov.al
web: www.fiu.gov.al